

Relacioni Teknik

Aktiviteti : **KARIERE PER SHFRYTEZIMIN E ARGJILAVE
NE ZONEN 308/6, MALIQ, QARKU KORÇE**

Shtojca 1 pika 19.Gurorë dhe miniera sipërfaqësore,ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 Hektare,ose vendet për nxjerrjen e torfes ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Subjekti: **“ALB STAR” sh.p.k ;**

Hartoi : Green Business Albania Studio



Hartoi : Green Business Albania Studio

Ekspert mjedisi : Elgerti Bixha

Ing. Mjedisi: Dhurata Lumani

PERMBAJTJE

- 1.Pershkrim i thjeshte, subjekti , konkurimi dhe kuadri ligjore
2. Te dhena te pergjithshme per objektin minerar
3. Vendndodhja e objektit
4. Popullsia, klima infrastruktura ekzistuese
5. Pjesa gjeologjike
6. Vetitë fiziko-mekanike të shkëmbinjve, dhe të xeherorit të dobishëm
7. Përbërja mineralogjike e trupit xeheror
8. Kushtet hidrografike dhe hidrogjeologjike të vendburimit.
9. Pjesa minerare
- 10 Kapaciteti nxjerrës i minierës, regjimi i punës
- 11.Sistemi i shfrytëzimit treguesit tekniko-ekonomike të tyre.
- 12.Punimet e zbulimit
- 13.Punimet e gërmimit të argjilës
- 14.Argumentimi dhe zgjedhja e pajisjeve të shpimit, ngarkimit dhe transportit
- 15Zgjedhja e shesheve të depozitimit të sterileve , mineraleve ose tenenprodukteve
16. Sigurimi teknik në proceset e punës për shfrytëzimin dhe administrimin e aktivitetit
- 17.Pjesa ndertimore
- 18 Rruget automobilistike për hapjen dhe shfrytëzimin e objektit
- 19 Objektet industriale e të shërbimit të makinerive dhe pajisjeve

1.Pershkrim i thjeshte, subjekti , konkurimi dhe kuadri ligjore

Të dhëna mbi subjektin , që ka aplikuar për marrje leje minerare shfrytëzimi

Emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR “**ALB STAR**” sh.p.k ;

i. Zona minerare Maliq zone nr.308/6 për të cilën kërkohet leja minerare e shfrytëzimit dhe që përfshihet në planin vjetor për vitin 2016;

ii. Lloji i mineralit për të cilin kërkohet dhënia e lejes argjile, shtrese izoluese e landfillit Maliq etj

iii. Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit aplikues për leje minerare sipas regjistrimit të QKR **Idajet ISMAILAJ** ;

iv. Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR, Bulevardi “Deshmoret e Kombit, Twin Towers, Godina nr. 2, Ka ti 5/1, Tirane

v. Nr i telefonit /faksit +35542280121 Fax:35542280120 infotr@albstar.al

vi. Emri i njësisë vëndore ku përfshihet zona e kërkuar Maliq, Qarku Korçe

b) Përshkrim i kapaciteteve tenike dhe profesionale dhe manaxheriale të kërkuesit

Subjekti “**ALB STAR**”shpk; është një shoqëri vendase me eksperience ne shfrytezimin dhe perpunimin e materialeve te ndertimit, si dhe aktivitetet te tjera ndertimi ne fushen e infrastructures

Gjate aktivitetit te saj, ajo ka akumuluar një eksperiencë shume vjeçare në fushën e shfrytezimit dhe perpunimit te inerteve per prodhime nenproduktesh ndertimi betone si dhe ndertime rruges, elemente te ndryshme infrastrukture, nderime ndertesash industrial dhe sociale etj dhe ka mundësi financiare për realizimin e investimeve të parashikuara për kryerjen e aktivitetit minerar të shfrytëzimit të mineralit te gelqerorit në objektin per te cilin ka konkuruar dhe ka fituar te drejten per aplikim per marrjen e lejes mierare të shfrytëzimit

2 Baza ligjore mbi të cilën subjekti kërkon të hartohet projekti si:

a) Zona minerar eshte shpallur si zone e hapur me nr.308/6 Maliq, Qarku Korçe, pasi subjekti ka fituar te drejten per ndertimin e nje landfili ne Qarkun e Korçes sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin inerar në Republikën e Shqipërisë”, pikës 22 dhe pikave 23 te tij si dhe të VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe dokumentacionit per marrje e lejeve minerare në zonat e hapura ”, me shkrese nr.1866/1 date 26.04.2016 te Ministrise

se Energjise dhe Industrise, shoqerise “Alb Star” sh.p.k i eshte dhene e drejta te aplikojte prane Qendres Kombetare te Licensimit per leje minerare shfrytezimi me karriere, per minerar argjile, me kushtet e lejuara per zonat e hapura per zonen minerarenr.308/6 ne objektin Maliq, Qarku Korçe

b) VKM Nr 364, datë 04.085.2011, “ Për për përcaktimin e kriterëve të vlerës minimale të zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare” Aneksi 2 i këtij vendimi “ Tabela për përcaktimin e vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit vlerënminimale të investimit për realizimin e prodhimit minimal vjetor për lejet minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit sipas grupeve të mineraleve” .

c) Për sa më sipër sipërfaqja e zonës së kërkuar për leje shfrytëzimi është më e madhe se vlera minimale e caktuar ne VKM Nr 364, datë 04.085.2011 e sipërcituara 1 ha nga 1 ha, vlera e prodhimit prej mbi 45000 ton/vit është më e madhe se ajo e përcaktuar në aneksin përkatës prej 10000 ton/vit gjithashtu dhe investimet janë 24.46 milion leke ndërsa shuma e përcaktuar në tabelën përkatëse të aneksit 2 të VKM Nr 364, date 04.05.2011 është 21 milion .

2. Zona minerare që kërkohet për marrjen e lejes minerare të shfrytëzimit është e përcaktuar në planin vjetor 2016 si zone e hapur me nr.308/6

Zona ka një sipërfaqe prej 0.096 km², një sasi rezervash të vlerësuar prej rreth 29 000 m³ argjila

3.Parametrat e pritshem të aktivitetit minerar do te jene :kapaciteti 25000m³ me një jetëgjatësi nje deri 20 muajdhe me një ekip punonjësish prej 4 specialistësh të fushave të ndryshme sipas proceseve te punës

3. Për realizimin e aktivitetit minerar të shfrytëzimit të këtij objekti do të nevojiten investimet e meposhtëme

Nr	Emertimi i investimeve	Vlefte e plote ne leke
1	Rruge,ndertim montime etj	460 000
2	Makineri pajisje	23586000
4	Shuma invetime te reja	460 000

5	Investime te bartura	23586000
7	Totali i investimeve	24 046 000

Të dhënat bazë gjeologjike sasiore dhe cilësore të objektit janë marrë nga studimet e kryera nga ish ITNPM , AKBN dhe SHGJSH si më poshtë

a) Ne objekt jan kryer punime gjeologjike te tipit kanale puse etj . Rezultatet e mara nga keto punime te kryer jane analizuar per treguesit e pershkueshmerise , pasi edhe argjila do te duhet te plotesoj kete kusht per tu perdorue ne ndertimin e lend fillit

c) **“Dinamika e zhvillimit të industrisë minerare për periudhën 2005-2008”** qe është kryher nga Ministria e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes dhe Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore me porosi të Këshillit te Ministrave, përfunduar 28 shkurt 2009 (E. Goskolli, G. Vasha. L.Dibra, A Çaushi, V. Mio etj)

2.Konsiderata te pergjitheshme

Shoqeria “Alb Star” sh.p.k eshte shoqeria e cila do te punoje ne bashkimin e perkohshem me shoqerine Goksin per llogari te Kompanise Rajonale te menaxhimit te mbetjeve Korçe per ndertimin e Landfillit ne Maliq, Korçe.

Bazuar ne marreveshjen kontraktuale per kete object si dhe nenit 22 dhe 23, te Ligjit 10304, dt,15.07.2010 “Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise, I ndryshuar, shoqeria kontraktore “AlbStar” sh.p.k , I eshte drejtuar Ministrise se Energjise dhe Industrise me kerkesen per tu pajisur me leje minerare shfrytezimi, mineral argjile, o cili do te perdoret si shtrese izoluese e landfillit Maliq,

Duke marre ne considerate interesat kombetare te projektit, objektivat e zhvillimit ekonomik te vendit, planifikimit te territorit, dhe detyrimeve ligjore kontraktualeper lehtesimin ne ushtrimin e veprimtarise minerare, ne rastet kur kjo veprimtari eshte me interest e veçant publik e kombetar dhe bazuar ne , Ligjit 10304, dt,15.07.2010 “Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise, I ndryshuar dhe VKM nr. 942, dt.17.11.2010, “Per miratimin e procedurave dhe te dokumentacionit per marrjen e lejeve minerare ne zonat e hapura, me shkrese nr.1866/1 date 26.04.2016 te Ministrise se Energjise dhe Industrise, shoqerise Alb Star” sh.p.k i eshte dhene e drejta te aplikojte prane Qendres Kombetare te Licensimit per leje minerare shfrytezimi me karriere, per minerar argjile, me kushtet e lejuara per zonat e hapura per zonen minerarenr.308/6 ne objektin Maliq, Qarku Korçe

Projekti i hartuar ka per qellim studimin e mundesise se shfrytezimit te argjilave per tu erdorur si shtrese izoluese ne landfillin e Maliqit te rrethit te Korçes nga subjekti privat, shoqeria ”ALB STAR” sh.p.k.,e cila ka marre r te drejten e aplikimit per leje minerare shfrytezimi per zonen e hapur Nr 308/6me shkresen e METE-s se sipercituar

Per hartimin e studimit tekniko-ekonomik dhe projektit te shfrytezimit te ketij objekti jane mare ne konsiderate:

Pozicioni gjeografik dhe mardheniet e objektit me qendrat e banuara;

Topografia dhe klima e zones ne te cilen ndodhet objekti i marre ne konsiderate;

Gjendja e karierrës në fund të afatit të vlefshmërisë ligjore të lejes së shfrytëzimit

Hidrologjia dhe hidrografia e zones ne te cilen kufizohet objekti i shfrytezimit;

Gjendja e infrastruktures se rajonit ne pergjithesi dhe te zones se objektit ,mundesite e permiresimit te saj, ndertime dhe instalime te tjera te domosdoshme per shfrytezimin e objektit nga pikpamja minerare;.

Materiali gjeologjik baze lidhur me ndertimin gjeologjik te rajonit dhe objektit, sasine dhe cilesine e rezervave gjeologjike dhe te shfrytezueshme brenda kufijve te percaktuer te shfrytezimit;

Matjet dhe dokumentimet e ndyshme te kryera ne teren lidhur me vetite gjeomekanike, karakteristikat fiziko-mekanike dhe parametrat gjeoteknike te formacione, qe ndertojne vendburimin, te cilat mund te kufizojne ne menyre te natyrshme permasat e blloqeve shkembore ne siperfaqe dhe thellesi te objektit dhe te detyrojne perdorimin e menyrave te pershateshme te rrezimit te gurit gelqeror;

Kerkesa te ndryshme per makineri, pajisje dhe investime te tjera per pergatitjen dhe shfrytezimin e objektit;

Llojet e produkteve te prodhuara dhe tregu i shitjes se tyre

Investimet e nevojshme etj;

Eksperienca e grumbulluar gjatë shfrytëzimit në objekte te ngjashme te zone ne te cilat eshte prodhuar argjile me qellim te perdorimit ne industrine qeramikes ;

3.Vendndodhja e objektit

Zona 308/6, vendburimi i Argjilave Maliq, Korç ndodhet rreth 2.5 km ne ne perendim te qytetit te Maliqit ne te majte te rruges qe pershkon luginen e Devollit Kuotat e objektit luahten nga 857 deri ne 849.5 m me nje diference kuotash 7-8.0m.

Kuota mesatare e objektit eshte: $H_{mes} = 85.0$ m. Siperfaqja e objektit: **S = 0.096 Km²**

Tereni ne pjesen e rilevuar paraqitet me nje pjeresi shume te bute gati te sheshet. Ai eshte pjeserisht i veshur me barishte te ulta, me siperfaqe me dalje argjilore te prishur nga agjentet atmosferike te prishur nga agjentet atmosferike dhe fenomenet e tjeterimitkiik dhe fizik. Ne afersi te tij nuk ka objekte te rendesise se vecante.Tokat perreth tij jane produktive, gje qe

faktorizojne shfrytezimin dhe mund te kushtezojne zgjedhjen e vendeve per depozitim ose shesh magazinimi.

Koordinatat e zonës

Nr.	Y	X
1	44 72 819.507	45 09 235.759
2	44 72 750.558	45 09 285.395
3	44 72 725.761	45 09 371.578
4	44 72 666.345	45 09 344.254
	44 72 671.340	45 09 307.190
	44 72 699.821	45 09 266.032
	44 727 55.802	45 09 218.263

- Sipërfaqja e zonës së kërkuar për shfrytëzim është $S=0.096 \text{ km}^2$
- Rezervat e e argjilave 60.000 ton.
- Al_2O_3 52.3 %

4. Popullsia, klima infrastruktura ekzistuese

Popullsia

Popullsia e kesaj zone i perket nje zone rurale dhe merret kryesisht me pune bujqesore dhe blegtorale. Ata banojne ne fshatrat perrreth me rreth si bashkia Maliq dhe Maliq fshat, etj dhe numri i pergjithshem i banoreve te komunes eshte 5250 banore,

Klima.

Objekti i kerkuar ben pjese ne Zonen fushore kodrinore te zones klimatike mesdhetare.

Klima ne rajonin ku do te kryhen punimet e shfrytezimit dhe perpunimit te gurit gelqeror paraqitet kontinentale me dimer relativisht te ashper dhe te ftohte dhe vere te fresket dhe te ngrohte.

Dimri qe pergjithesisht eshte i ashper dhe me lageshti shoqerohet shpesh dhe me rreshje bore, te cilat, disa here, arrijne trashesin mbi 1 m duke shkaktuar bllokimin e perkohshem te rruges, ndersa vera e ngrohte me pak lageshti . Ne zone ka mbi 1650 ore ndricim dielli, korriku 2855 ore dhe dhjetori 75 ore. Temperatura mesatare vjetore e ajrit eshte 12.6 grade Celsius, ne Korrik dhe Gusht temperatura shkon 26-36 grade Celsius, ndersa ne janar zbret ne 6 grade Celsius, disa here dhe disa grade nen zero.

Vlera mesatare e rreshjeve shkon ne 2215 mm/vit. Ne periudhen tetor-maj bien 75% e rreshjeve. Sasia maksimale e rreshjeve eshte rregjistruar gati 168 mm shi ne 24 ore (2006).

Lageshtia e ajrit rezulton sipas stineve nga 68% - 74%.

Drejtimi i ererave eshte kryesisht Veri Perendim –Juge Lindje qe perputhet me drejtimin e pergjithshem te fushes se MALiqit dhe ne raste te rralla oblik me te Ushtrimi i aktiviteti te shfrytezimit te argjiles, duke mare ne konsiderate masat e parashikuara ne projekt, nuk do te ndikojne ne ndryshimin e parametrave fizike te ajrit dhe nuk do t'a ndote ate.

Hidrologjia dhe hidrografia e zones ne te cilen kufizohet objekti i shfrytezimit

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash. Ne pjesen veriore te zones kalon lumi Devollit, por qe eshte rreth 30 nen nivelin fundor te objektit e nuk ka ndikim ne te

Bimesia.

Vendi ku kerkohet leja e shfrytezimit eshte pothuajse i zhveshur nga bimesia .Ne aferi te saj (ne Jug te zones ne fjale) rriten pishe e larte. Ne zonen e dherave (mbuleses qe nuk perfaqeson rezerva gjeologjike argjilore) rriten lule dhe bar.

Infrastruktura ekzistuese.

Objekti i kerkuar per marrjen e lejes minerare te shfrytezimit ndodhet ne ane te rruges qe shkon nga qyteti I Maliqit ne drejtim te fshatit Maliq e ne drejtim te lugines se Devollit Ushtrimi i aktivitetit bujqesor ne zone ka beret e mundur ndertimin e nje rrjeti shume te dendur rruges qe lidhin objektet e shfrytezimit me rrugen kryesore .Rruga kryesore dhe ato dytesore ne zone jane kryesisht ne gjendje te mire te pashtruara dhe shfrytezimi i ketij objekti do te ndikojne dukshem ne permiresimin e infra se zones.

5.PJESA GJEOLIGJIKE

Rajoni ne te cilin ndodhet objekti minera i perrfshre ne zone inerare nr 308/6, ben pjese ne zone tektonike Mirdita Ne rajonin ku ndodhet vendburimi i gelqeroreve Maliq jane kryer rilevime gjeologjike, dhe punime te tjera kerkim zbulimi per vendburimet e qymyreve, , si dhe punimet gjeologo – inxhinerike te bera gjate kohes se kerkim zbulimit te qymyrit ne kete pjese te vendit , nga Ndermarja Gjeologjike e Korçes, jane permbledhur ne publikime te ndryshme shkencore dhe ne raporte gjeologjike te kerkim zbulimit te vendburimeve te veçanta dhe te rajonit ne pergjithesi. Rajoni i eshte nenshtuar punimeve te shumta gjeologjike dhe studimore per zbulimin e vendburimeve te qymyrgurit .

Ndertimi gjeologjik dhe petrografik i kesaj zone ka qene objekt studimesh dhe pergjithesimesh te kryera nga Fakultetit te Gjeologjise dhe Minierave, publikimesh te ndryshme te Specialisteve te Institutit te Studimeve dhe Projektive Gjeologjike ne buletin e Gjeologjise deri ne vitin 1990, punime e ndryshme te kryer per harten gjeologo strukturore te vendit dhe se fundi ne kete zone jane kryer punime te shumta shfrytezimi kryesisht ne pjesen e siperme te prerjes

Shtrihet ne te dy krahjet e fushes se Korces, por me perhapje me teper ne P se sa ne L. Perfaqesohet ne baze nga gelqerore litotamnike e me tej me nderthurje te ranoreve me alevrolitet e shpesh ne pjesen e siperme nga nje pako e fuqishme alevrolitore. Kane trashesi te konsiderueshme qe i kalon 500-600 m. Ne pjese te vecanta si ne Kamenice apo Vincan- Kolanec ne baze jane konglomerratike. Kane renie kryesisht L me kende te buta e marrin pjese ne ndertimin e sinklinalit te Korces. Vet bazamenti i fushes se Korces perfaqesohet nga keto depozitime te vertetuara keto edhe nga shpimet e thella (1080 m) te kryer nga Nafta.

6. Vetitë fiziko-mekanike të shkëmbinjve, dhe të xeherorit të dobishëm

Nga analizat e treguesit fizike te percaktiveve granulometrike arrijme ne konkluzionin se horizonti produktiv i vendburimit te argjilave Maliq perfaqesohet nga nje game kalimtare midis argjilave dhe alevroliteve deri ne suargjila. Persa i perket ketij treguesi teknologjik ky material eshte i pershtatshem per prodhimin e qeramikes se trashe. Duke pergjithesuar te dhenat granulometrike shohim se ne keto argjila predominojne kokrizat ose thermijat me dimensione 0.05mm deri 0.01mm kurse kokrizat me dimension (1.0-0.5) mm zene nje mase te pandjeshme ne perberjen e mases argjilore.

Ky pergjithesim i perberjes fraksionare eshte si me poshte:

Tabela Nr 2 Perberja granulometrike e argjilave

Nr	Diametri I kokrizave	Përbërja fraksionare [mm] [%]
1	1.0 -0.5	deri (1-2)
2	0.5 -0.25	(1-2)

3	0.25-0.1	(4-5)
4	0.1 -0.05	(40-50)
5	0.05-0.01	(10-20)
6	0.01-0.005	(8-9)
7	0.008-0.002	(9-10)
8	0.002-0.001	(7-8)

Shenim: Madhesi e shprehur ne % e sasise se pergjithshme

Nen diametrin 0.001mm (7-8) % , argjilat e vendburimit Korçe, konsiderohen si argjila me plasticitet mesatar deri plastike. Vlera e treguesit te plasticitetit varion nga: (6.4 - 15.2). Pjesa qendrore e vendburimit ka tregues plasticiteti 10.6.

Pesha volumore e ketyre argjilave leviz nga: = (1.65 - 1.81) t/m³.

Nga "ALB STAR" shpk jane bere analiza te shtreses produktive ne Itali, ne laboratorin Teknologjik " Geoceramic Researches Laboratorio Tecnologico per i Material Ceramic" dhe rezultojne si me poshte:

7. Përbërja mineralogjike e trupit xeheror

Horizonti produktiv perbehet prej argjilave, argjilo-rerave dhe nderfutjeve sterile te perfaqesuara kryesisht nga rera kokerimet deri kokermesem rrale zhavore, (foto Nr.4) mjaft te shkrifeta. Argjilat ndertojne zakonisht pjeset me te siperme te prerjes.

Neper masen argjilore takohen kokrriza dhe copra te lendes karbonatike e ultrabazike te shperndara pa rregull ne masen argjilore. Nga studimi i kampioneve te marra ne te gjithe fushen e vendburimit argjilave Maliqper perberjen kimike te ketyre argjilave rezulton kjo permbajtje:

Tabela Nr 3 Perberja kimike e argjilave

Nr	Përmbajtja kimike	SiO ₂	Al ₂ O ₃	Fe ₂ O ₃	CaO MgO	
%	%	%	%	%		
1	Minimale	41.61	11.47	5.99	8.05	5.66%
2	Maksimale 52.81	14.07	7.58	14.00	6.80%	
3	Mesatare	44.72	12.54	6.67	11.68	6.24%

Duke pare rezultatet e te gjitha provave per analize kimike te krijuhet mendimi se keto argjila kane homogjenitet ne permbajtjen kimike te tyre. Krahas percaktimeve te tjera per te patur te qarte perberjen lendore te vete argjilave u analizua mineralogjia e tyre, e cila jep keto rezultate: Materiali perbehet nga fraksioni i lehte i perbere nga:

Tabela Nr 4 Perberja mineralogjike e argjilave te objektit

Nr.	Lloji i mineralit	Permbajtja[%]
1	Agregate argjilo-karbonatike	94.0
2	Kuarc	5.0
3	Feldshpate	0.5
4	Muskovit	0.5

Kokrrizat e kuarcit jane te pastra, te parregullta dhe zene nje perqindje te vogel ne masen e materialit. Permbajtja e Al_2O_3 si komponent i dobishem paraqitet pothuajse ne vlerat kufi te domosdoshme per procesin e prodhimit. Ne varesi te permbajtjes te ketij komponimi ndryshojne ne kufij te gjere treguesit teknologjike per pridhim si plasticiteti, ujethithja, poroziteti, tkurrja.

8. Kushtet hidrografike dhe hidrogeologjike të vendburimit.

Rrjeti Hidrografike i vendburimit. Vendburimi i argjiles zona 308/6Maliq ndodhet ne te majte te rrjedhjes se lumit Devoll. Zona eshte e nderprere nga nje rrjet dendur kanale veditese e kullues, me gjatesi, drejtim e dimensione te ndryshme qe rrjedhin drejt lumit Devollit, te cilat ne periudhen me rreshje kane mjaft uje, kurse gjate veres, shumica e tyre thahen fare.

Kushtet Hidrogeologjike te vendburimi. Ujrat nentokesore te shkembinjve te shkrihet (ose ujrat e poreve) lidhen me shkembinjte e palidhur te Kuaternarit, qe karakterizohen nga nje pershkueshmeri e madhe deri ne e vogel. Fushae Maliqit eshte e mbushur me depozitime Kuaternare aluviale, te cilat permbajne disa shtresa ujembajttese zhavore-zhure, te ndara midis tyre nga shtresa suargjila e argjila.

9. Pjesa minerare

Ne hartimin e pjeses minerare te ketij studimi, percaktimin e menyres se shfrytezimit rradhen e shfrytezimit dhe elemente te tjere, jane mare ne konsiderate Topografia e objektit ne zonen e shfrytezimit dhe per rreth saj Sasia e rezervave te nxjerreshme ne kuota ta ndryshme te vendburimit në pjesën e mbetur • Sasia e mbuleses dhe e sterileve qe duhet te zhvendosen jashte zones se shfrytezimit apo me qe mund te depozitohen brenda saj

Koefiçenti mesatar i zbulimit

Mundesite e lidhjes se vendburimit me rrugen nacionale

Karakteristikat fiziko-mekanike dhe gjeomeknike te formacioneve qe ndertojne vendburimin

Sistemi i çarjeve, orientimi i tyre dhe materiali mbushes qe ndodhet ne to

Tregues te rendesishem gjeomeknike dhe gjeoteknike si RQD dhe RMR

Transportin e brendshem deri ne sheshin m me kamiona.

10 Kapaciteti nxjerrës i minierës, regjimi i punës

Pas llogaritjeve paraprake rezervat gjeologjike dhe te nxejreshme te ndara perkatesisht ne shkalle dhe treguesit e tjere jane dhene ne tabelen e me poshteme Ne tabelen e treguesave pjesa e rezervave qe jane diference midis volumit te pergjithshem dhe rezervave te konvertuar eshte konsideruar si mbetje sterile dhe ne tabelen e meposhte eshte dhene koefiçenti i zbulimit ne m³/ton

Duke mare ne konsiderate elemente te tjere si: topografine, sasine e rezervave , karakteristikat gjeomekanike te formacioneve, elementet e shtruarjes, eshte parashikuar shfrytezimi me karriere i rezervave argjilave të llogaritura te objektit dhe me poshte jane paraqitur llogaritjet perkatese. Shfrytëzimi me qiell të hapur, gjithashtu, favorizohet nga:

Renia e formacioneve, qe ndertojne pakon produktive ne drejtim te tillë që lejojnë zhvillimin normal proceseve teknologjike te shfrytezimit pa sjelle kushtezime teknike.

11.Sistemi i shfrytezimit treguesit tekniko-ekonomike te tyre.

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane mare parasysh faktoret e meposhtem:

Menyra e ngarkimit dhe transportit te sterilit

Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit

Menyra e ngarkimit dhe transportit te argjilave ne brendesi te karrieres dhe jashte saj

Ngarkimi i argjiles ne te gjitha sheshet e karrieres parshikohet te kryhet me fadrome ose eskavator me kove 1-1.5 m³ Bazuar ne sa me siper sistemi i shfrytezimit qe parashikohet te perdoret eshte i thjeshte me transport te sterilit ne distance deri 08 km, duke lejuar ne kete menyre depozitimimin e sterilit ne brendesi te karrieres te karrieres, ne zonen ku eshte germuar me pare .

Elementet e sistemit te shfrytezimit qe parashikohet te perdoret ne kete objekt jane • Lartesia e shkalles se karrieres eshte 10m

Gjeresia e sheshit te punes nga 12-20 m

Kendi i skarpates se shkalles 45°

Kapaciteti ditor 1500 ton/dite

Bartja dhe transporti i mekanizuar;

Rezimi i i argjiles me perdorimin e mjeteve gryeres apo koves se eskavatorit

12.Punimet e zbulimit

Vetite gjeomekanike te formacioneve qe ndrtojen e vendburimin ne pergjithesi dhe ne pjesen qe do te shfrytezohen jane kryesisht te gryshem me ane te mjeteve mekanike dhe nuk kane nevojte per kryerjen e punimeve me lende palse Punimet per zbulimin e objektit jane teper te thjeshta dhe mund te kryhen me dy menyra Largimi i mbuleses se shkrifet duke perdorur fadrome; Ne te dy menytrat e perdorur per realizimin e ketij procesi masa e dherave te mbledhura do te largohen per tu depozituar ne zonen e lene per kete qellim brenda karrieres

13.Punimet e germimit te argjiles

Per germimin apo grumbullimin e argjiles, ne projekt parashikohen te perdoren gjithashtu dy menyra :

Germimi i argjiles me eskavator me lopate mekanike me kapacitet kove 1-1.5 m³. Ne kete rast eskavatori mund te vendoset ne shkallen e argjiles dhe te germoje duke u terhequr ose te grysje ne balle duke e pasur shtresen perpara

14.Argumentimi dhe zgjedhja e pajisjeve te shpimit, ngarkimit dhe transportit

Siç eshte permendur ne pjesen “zbulimi dhe prodhimi”, vellimi i pergjithshem i prodhimit do te jete rreth 25 000 m³ ose rreth 37 000 ton. Kapaciteti ditor do te jete 1300 ton/dite

Makinerite dhe paisjet disonibel nga subjekti do te perballojne prodhim 1500 ton/dite

Percaktimi i numurit te mjeteve te germimit ose gryerjes :

Siç është theksur dhe me sipër për realizimin e proceseve të germimit po gërmerjes së mbulesës dhe argjilave parashikohet të përdoret eskavator ose skreper i tërhequr nga mjet motorik me zinxhir ose me gomë

Nr Emertimi Njesia Sasia

1 Prodhim tont 37000/muaj

3 Kapaciteti ditor në prodhim ton/dite 1500 ton

Përcaktimi i numurit të mjeteve të ngarkimit.

Për ngarkim të argjilës do të përdoren eskavatore të fuqishëm me kapacitet kocke 2- 2.5 m³

1 Prodhim mujor 37 000 ton/muaj

6 Numri i nderësive nderesa në ditë 1

7 Dite punë në muaj 30 ditë

8 Ore punë në nderesë 7 Ore

9 Kapaciteti orar i eskavatorit 90 m³/ore

10 Kapaciteti ditor i eskavatorit 630 m³/ditë

11 Nr i eskavatoreve 1.57 cope 2 Cope

Nga tabela e mësipërme përcaktohet se numuri i mjeteve të ngarkimit do të jetë 2 cope në rastet e nevojave urgjente në karrirë mund të punohet dhe me dy nderesa pa patur nevojë për makineri ngarkimi shtesë

Përcaktimi i numurit të mjeteve të transportit.

Për transportin e sterilit dhe mineralit parashikohet të përdoren automjete 10 toneshë.

Përcaktimi i numurit të mjeteve të transportit

1 Prodhim mujor 37 000 ton/muaj

6 Numri i nderësive nderesa në ditë 1

7 Dite punë në muaj 30 ditë

8 Ore punë në nderesë 7 Ore

9 Kapaciteti transportues i mjetit të transportit, 40 ton

10 Distance transportit vajtje ardhje 10 km

Shpejtësia e levizjes 20km/ore

Nr. Reizeve 3 reize /ore

Kapaciteti orar i mjetit 3* 40 ton 120 ton/ore

Kapaciteti ditor i mjetit 840 ton/dite

Nr i mjeteve te transportit 2 mjete me kapacite 40ton

Perfundimisht, per transportin e argjiles do te nevojiten 2 kamiona me ngarkese bartje 40 ton .

Zgjedhja e buldozereve dhe numri i tyre

Per zbankimin dhe sistemimin e nje pjese te streileve ne distancen maksimale te prashikuar ne projekt eshte i mjaftueshem perdorimi i nje buldozieri KOMACU 115. Theksojme se treguesit teknike te ketyre makinerive te ngarkimit dhe transportit jane te tilla qe mund te perballojne kapacitet me te medha prodhimi, por ato mund te perdoren dhe per kryerjen e punimeve te tjera qe subjekti kryen jashte atij te shfrytezimit te mineralit. Buldozieri eshte tashme ne inventar te subjektit

15.Zgjedhja e shesheve te depozitimit te sterileve , mineraleve ose te nenprodukteve

Gjate kryerjes se proceseve te zbulimit, skarifikimit te pjeses se gryer per sistemimin e rruges dhe atyre te prodhimit parashikohet te veprohet si me siper Sasia e pergjitheshme e zbulimit eshte e pa perfilleshme Gjithesesi, ne project eshte parashikuar nje shesh provizor per depozitimin e pjeses se mbulesese e cuila ne perfundim te shfrytezimit do te ridepozitohet ne karriere per tu perdorur si shtrese vegjetale per tu mbjelle me peme karakteristike te zones..

Ne planimetrine perkatese eshte konturuar siperfaqja e depozitimit te sterileve Sterilet e depozituara do të përdoren për rehabilitimin progresiv të karrierës i cili do të fillojë që në vitin e dytë të aktivitetit . Depozitimi i sterileve ne kete siperfaqe do te beje te mundur qe me pas sterilete qe do te dalin nga shfrytezimi te depozitohen ne zonen e shfrytezimit qe do te krijohet ne vazhdimesi.

16. Sigurimi teknik ne proceset e punes per shfrytezimin dhe administrimin e aktivitetit

a)Zbatimi i normave te rregullores se teknikes se sigurimit

Gjate ushtrimit te aktivitetit minerar subjekti duhet te mbaje parasysh qe problemet e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune jane me te rendesishmet dhe me te mprehta dhe kerkojne vleresim serioz Para se gjithash ne te gjitha operacionet do te punesohen specialiste me eksperience pune ne kryerjen e proceseve te ndryshme te karakterit minerar Drejtuesi teknik i

punimeve para fillimit te punes do te zbatohet rregullat dhe normat e percaktuara ne Regulloren e Teknikes se Sigurimit per Minierat dhe Karierat te Vitit 1999 te hartuar nga Instituti i Teknologjise Nxjerrese dhe Perpunuese te Mineraleve te miratuar me urdher te Ministrit Nr 132 date 07.04.1999 , mbeshtetur ne nenin 17 te Ligjit Minerar Shqipetar Nr 7796 date 17.02.1994. Regullorje e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik te punimeve dhe subjektit , do te zbatohet ne cdo proces pune te percaktuar ne plan- organizimin e kryerjes se punimeve te hartuar nga ai dhe te miratuar nga drejtuesit e firmes.

Plan organizimi i punimeve do te hartohet para fillimit te punimeve

Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve

Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar do te beje kontrollin teknik dhe azhornimin e sakte te punimeve minerare te cdo lloji per te cilat subjekti ka marre license Rradha e kryerjes do te percaktohet hollesisht ne planin e masave teknikoorganizative dhe do te miratohete nga pronari i firmes Ne kete plan tekniko-organizativ masat e teknikes se sigurimit do te zene vendin kryesor. Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruksione te rregullta mujore e tre mujore , ku do te trajtohen tema te vecanta per te gjitha profesionet Punonjesit qe do te punojne ne karriere per kontrollin e shpateve te shkalleve, shesheve te ngarkimit , rrugeve te transportit do te testohen cdo tremujor kundrejt firmes . Kujdes i vecante do te tregohet ne krijimin e kushteve te punes , pastrimit te shesheve te shkalleve ,rrugeve te transportit, krefjes se shpateve te shkalleve te punes dhe nenshkalleve etj. Kujdes i vecante do ti kushtohet ruajtjes se pjeresise se shesheve te punes ne drejtim te transhese se hyrjes per te siguruar rrjedhjen e ujrave te rreshjeve dhe llumrave te ndryshme te krijuar gjate tyre

b) Sigurimi nga rreshqitjet dhe rruajtaje kendeve te skarpatave te llogarituara

Duke pasur parasysh treguesit treguesit gjeomekanik te formacineve eshte llogaritur kende I skarpates duke perdorur metodat kompiuterike te cilat se bashku me rezultatet e tyre paraqiten ne tabelen e meposhteme

Tabela Nr14 Vlera e kendit te skarpates e llogaritur sipas metodave

Nr	Metoda	Rezultati i kendit	Koeficienti i sigurise
1	FELENIUS	52o	1.24
2	BISHOP	50 o	1.36
3	SPENCER	49 o	1.2
4	RAULIN	50 o	1.13
5	JANBU	52 o	1.14
6	MORGENSTERN E PRICE	47 o	1.16

Nga llogaritjet e mesiperme del se kendi i skarpates eshte nga 47 o deri ne 52 o , ndersa koeficienti i sigurise, nga 1.13 - 1.36 Bazuar ne llogaritjet e mesiperme, jane bere llogaritje shtese te kendit te skarpates duke mare ne konsiderate dhe pranine eventuale te ujit te rreshjeve. Pas llogaritjeve te mesiperme kendi I karpates eshte pranuar 45o Koeficienti i sigurise eshte pranuar 1.2 (rekomanduar nga literatura perkatese per nje kohe ekspozimi mbi 25 vjet) Kendi i skarpates ne pjeset me perkulje konvekse te shkalleve (cepat e karrieres) eshte pranuar 2-4 grade me i vogel Per te siguruar nje qendrueshmeri normale te skarpatave dhe shesheve te punes parashikohet qe sheshet e punes te kene nje pjeresi prej 1-2% ne drejtim te transhese kryesore duke siguruar rrjedhen normale te ujrave dhe duke parandaluar ngopjen e formacionve argjilore nga uji

17.Pjesa ndertimore

Shfrytezimi i argjiles ne zonen minerare Nr 308/6te ketij objekti eshte nje aktivitet i mirefillte minerar i subjektit per sigurimin e lendes se pare te hidroizolimin e landfililit nga rrjedhat e ujit, tjegulave dhe produkteve te tjera te qeramikes per hapjen , pergatitjen , shfrytezimin e argjiles, perpunimin e tij dhe kryerjen e proceseve te tjera te sherbimit te makinerive dhe pajisjeve parashikohen te ndertohen objektet e permendura.

18. Rruget automobilistike per hapjen dhe shfrytezimin e objektit

Prer hapjen e objektit parashikohet te hapet nje rruge me gjatesi 0.4 km me gjeresi 6 m dhe pjeresi 7-8-%. Ne ane te rruges do te ndertohet dhe nje kanal i cili do te sherbeje per kullimin e ujrave . Rruga do te pershkoje teresisht zonen e shfrytezimit nga ekstremi verior i saj drejt atij jugor.

19.Objektet industriale e te sherbimit te makinerive dhe pajisjeve

Ne objekt nuk parashikohen te ndertohen objekte industriale dhe te sherbimit per qellime te ndryshme do te perdoren ato të ndërтуara nga subjekti vitet kaluara dhe qe jane ne teritorin e fabrikes se tullave.Ne objekt nuk parashikohen te ndertohen objekte soclaie, pasi aktivitetieshte I perkoheshem.Gjate shfrytëzimit në te argjiles nuk parashikohet te perdoren makineri dhe pajisje te ndryshme te cilat punojne me energji elektrike . Makinerit jane te gjitha me motor me diegie te brendeshme kryesisht me nafte Lidhja telefonike e objektit me subjektin do te behet me telefona mobile.Ne objekt parashikohen te ndertohet nje objekt i cili do te sherbeje si magazine dhe

ambient

per

rruajtjen

e

pjesëve

te

kembimit

Perfundimet

Shoqëria "Alb Star" sh.p.k është shoqëria e cila do të punojë në bashkimin e perkohshëm me shoqërinë Goksin për llogari të Kompanisë Rajonale të menaxhimit të mbetjeve Korçe për ndërtimin e Landfillit në Maliq, Korçe.

Bazuar në marrëveshjen kontraktuale për këto objekt si dhe nenit 22 dhe 23, të Ligjit 10304, dt.15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë, I ndryshuar, shoqëria kontraktore "AlbStar" sh.p.k, I është drejtuar Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë me kërkesën për tu pajisur me leje minerare shfrytëzimi, mineral argjile, o cili do të perdoret si shtrese izoluese e landfillit Maliq,

Duke marrë në konsideratë interesat kombëtare të projektit, objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit, planifikimit të territorit, dhe detyrimeve ligjore kontraktuale për lehtësimin në ushtrimin e veprimtarisë minerare, në rastet kur kjo veprimtari është me interes të veçant publik e kombëtar dhe bazuar në Ligjin 10304, dt.15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë, I ndryshuar dhe VKM nr. 942, dt.17.11.2010, "Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, me shkresë nr.1866/I date 26.04.2016 të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, shoqëria "Alb Star" sh.p.k i është dhënë e drejta të aplikojë pranë Qendrës Kombëtare të Licensimit për leje minerare shfrytëzimi me karriere, për mineral argjile, me kushtet e lejuara për zonat e hapura për zonën minerare nr.308/6 në objektin Maliq, Qarku Korçe

Zona 308/6 vendburimi i Argjilave Maliq, Korçë ndodhet rreth 2.5 km në perëndim të qytetit të Maliqit në të majtë të rrugës që përkrah luginën e Devollit Kuotat e objektit luan tërësisht nga 857 deri në 849.5 m me një diferencë kuotash 7-8.0m.

Kuota mesatare e objektit është: $H_{mes} = 85.0$ m. Sipërfaqja e objektit: $S = 0.096$ Km²

Tereni në pjesën e rëlevuar paraqitet me një pjerrësi shumë të butë gati të sheshtë. Ai është pjesërisht i veshur me barishte të ulta, me sipërfaqe me dalje argjilore të prishur nga agjentet atmosferike të prishur nga agjentet atmosferike dhe fenomenet e tjetërimitiik dhe fizik. Në afërsi të tij nuk ka objekte të rëndësishme të vecante. Tokat përreth tij janë produktive, gjë që faktorizojnë shfrytëzimin dhe mund të kushtëzojnë zgjedhjen e vendeve për depozitim ose shesh magazinimi.



